

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

MARKETING & DISTRIBUTION

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

J72124001N

NUIS/NIPT

Autostrada Tirane - Durres, Km.10

Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0692085141

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

hr@markdist.com

E-mail

Administrator i delguar Klaudia Llaha

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

2023/07/31

Data (viti/muaji/dita)

0693624393

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-75817-07-24-2023

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Local

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara

Vlera e përlogaritur e prokurimit

Vlera e përlogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

3716833

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

“Materiale kancelarie të tjera zyre”,

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2023/08/09

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Mallra

2023/08/09

Numri i njoftimit

Kodi CPV

REF-75817-07-24-2023

22852000-730192124-630192130-1

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

1. Ligji nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar
 2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285 date 19.05.2021 “Pe?r miratimin e Rregullave të prokurimin publik” i ndryshuar,
 3. Direktiva nr. 24/2014 “Pe?r prokurimin publik” Këshillit të Europës
-

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit
- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkon pavlefshmërinë)

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet □

Përshkruani rrethanat e faktit. □

Nr.	Emërtimi i produktit	Njësia matëse	Sasitë e pritshme
15.1	Bojë vulë blu kuti metalike	shishe	52
15.2	Bojë vulë blu kuti plastike	shishe	70
16.1	Bojë vulë e zezë kuti metalike	shishe	1
22/1.	CD-R min 48X, 700 MB copë	300	
22/2.	CD-R min 48X, 700 MB bobinë	30	
26/1.	DVD-R, 16 x 4.7GB	pako	330
26/3.	DVD-R, 16 x 4.7GB	copë	70
58.1	Kalkulator 16 digit me energji diellore	copë	3
58.2	Kalkulator 16 digit me bateri	copë	12
97/1.	Lapsa me gome HB	pako	16
97/2.	Lapsa me gome HB	copë	720
184	Makine kapese 8 metalike	copë	10
185	Mbajttese dokumentash 3 sirtare	copë	5
187	Tapete per mouse	copë	5
188	Telaper makina kapese 6/4	kuti	100
196	RAM per PC 8GB	copë	30

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

Shoqëria “Marketing & Distribution” Sh.p.k me Nipt J72124001N, përfaqësuar nga Administratori i Përgjithshëm Z. Besnik NUSHI, në vijim të procedurës së prokurimit publik “Procedure e hapur”, shpallur nga Autoriteti Kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara, me objekt: Loti II “Materiale kancelarie të tjera zyre”, me numer REF-75817-07-24-2023, me fond limit 3,716,833.16 (tre milion e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë e tre pikë gjashtëmbëdhjetë) lekë (pa TVSH), publikuar më datë 25.07.2023, referuar në afatin 7 (shtatë) ditor të parashikuar nga Ligji nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik“ konkretisht Neni 110 “Afatet për ankim” pika 2 i cili citon “Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”, lidhur me të drejtën e ankimit pas publikimit të dokumenteve standarte të tenderit, po ju parashtrijmë në vijim arsyet ligjore ku bazohen këto kundërshtime:
Në shtojcën 6 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit” është kërkuar ndër të tjera nga ana Juaj si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i produktit	Njësia matëse	Sasitë e pritshme
-----	----------------------	---------------	-------------------

15.1	Bojë vulë blu kuti metalike	shishe	52
15.2	Bojë vulë blu kuti plastike	shishe	70
16.1	Bojë vulë e zezë kuti metalike	shishe	1
22/1.	CD-R min 48X, 700 MB copë		300
22/2.	CD-R min 48X, 700 MB bobinë		30
26/1.	DVD-R, 16 x 4.7GB	pako	330
26/3.	DVD-R, 16 x 4.7GB	copë	70
58.1	Kalkulator 16 digit me energji diellore	copë	3
58.2	Kalkulator 16 digit me bateri	copë	12
97/1.	Lapsa me gome HB	pako	16
97/2.	Lapsa me gome HB	copë	720
184	Makine kapese 8 metalike	copë	10
185	Mbajttese dokumentash 3 sirtare	copë	5
187	Tapete per mouse	copë	5
188	Telaper makina kapese 6/4	kuti	100
196	RAM per PC 8GB	copë	30

Në lidhje me artikujt e lartpërmendur dhe të kërkuar me sasi konkrete në shtojcën nr. 6 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit” për Lotin II “Materiale kancelarie të tjera zyre” nga ana e autoritetit tuaj kontraktorë, konstatohet se në shtojcën nr. 5 “Formulari i specifikimeve teknike” të po këtij loti në të cilën duhet të ishin të rënditura specifikimet teknike për artikujt e atakuar, mungojnë specifikimet teknike.

Nga sa më sipër kërkojmë nga ana e autoritetit kontraktorë që të bëjë hartimin e specifikimeve teknike të nevojshme për artikujt e lartatakuar, specifikime të cila duhet të përshkruajnë në mënyrë sa më të saktë artikullin pasi çdo pasaktesi mund të përbëjë shkak për konfundimin e OE pjesëmarrës dhe më pas për skualifikimin e tyre.

Gjithashtu në lidhje me artikullin nr. 22/2 “CD-R min 48X, 700 MB” kërkojmë nga ana e autoritetit kontraktorë që të na sqarojë sa copë CD duhet të ketë një bobinë pasi në treg ka bobina që përmbajnë 50, 100 CD.

Përsa i përket artikullit 26/1 “DVD-R, 16 x 4.7GB” të kërkuar në shtojcën nr. 6 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit” kërkojmë nga ana e autoritetit kontraktorë që të na sqarojë sa cope DVD-R duhet të ketë një pako.

Mungesa e specifikimeve teknike bie në kundërshtim siç vijon:

? Në nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin Publik” përcaktohet se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të

pe'r caktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pike 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të

shoqërohet nga fjalejt "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalejt "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pike 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pike 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor."

Ligjeve nëse ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin Publik", 2 Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit.

Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i

vetëm.

Në hartimin e specifikimeve teknike autoriteti juaj kontraktore duhet të mbajë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, gjykojmë se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike.

Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën.

Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve.

Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikeve 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit.

Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

? Gjithashtu mosvendosja e specifikimeve të tilla bie në kundërshtim me nenin 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” Këshillit të Europës, ku parashikohet se: “Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojcës VII do të përcaktohen në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”.

Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: specifikim teknik nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modeli për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdoruesdhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit;

Në vendimin e GJED çështja C-368/10 “Komisioni Europian vs. Mbretëria e Hollandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga

autoritetet kontraktuese.”

Ne gjykojmë se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 të paragrafi “dh” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

Në këtë kuadër, pasi evidentuam gjithë bazën ligjore që është shkelur nga ana e Autoritetit Kontraktor në mos hartimin e specifikimeve teknike lidhur me artikuj e lartpërmendur, pretendojmë se autoriteti kontraktor duhet të pranojë pretendimet e sipërcekura.

Për të gjitha sa u parashtruan më sipër, në zbatim dhe përputhje me Ligjin nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285 date 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Direktiva nr. 24/2014 “Për prokurimin publik” Këshillit të Europës, kërkojmë që Autoriteti Kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara dhe Komisioni i Prokurimit Publik, të ndryshojnë kriteret dhe specifikimet e artikujve të sipërpërmendur si të pabazuara në ligj dhe në prova në mënyrë që të rrisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë..

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,
Tiranë me 31.07.2023

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po Jo
? X

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

_____JO_____

7. Lista e informacionit konfidencial:

_____NA_____

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Nr. i faksit:

E-mail:

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkonti)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

JO

7. Lista e informacionit konfidencial:

NA

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

hr@markdist.com

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Besnik Nushi